

1. Furnizim me sistem informacioni dhe pajisje në një vendndodhje qendrore për Platformën e Menaxhimit të Kontrollleve dhe Hetimeve Doganore**Duration:** 12.01.2026 - 11.11.2026**Countries:**
North Macedonia**EU contribution:** € 736 970**Total budget:** € 736 970**Implementer:**
ASEE DOOEL Skopje**Project description:**

Ky veprim mbështet transformimin digjital dhe forcimin e kapaciteteve operationale të Administratës Doganore, duke krijuar një platformë të brendshme për kontroll dhe hetime elektronike, së bashku me sigurimin e infrastrukturës së përpunuar të teknologjisë së informacionit (TI-së).

Projekti prezanton zgjidhje të dedikuara softuerike e cila mundëson mbledhjen, menaxhimin dhe analizimin sistematike të të dhënave që lidhen me operacionet doganore, monitorimin, hetimet dhe ndjekjen penale të rasteve të krimit ndërkufitar. Duke përmirësuar qasjen në informacion dhe përdorimin e tij, platforma rrit koordinimin, efikasitetin dhe vendimmarrjen e bazuar në prova brenda Sektorit për Kontroll dhe Hetime.

Paralelisht, furnizimi me pajisje të teknologjisë së informacionit me performancë të lartë për dhomën qendrore të serverëve siguron besueshmërinë, sigurinë dhe kapacitetin e përpunimit të nevojshëm për trajtimin e vëllimeve të mëdha të të dhënave operative. Së bashku, këto ndërhyrje kontribuojnë në një kontroll doganor më efektiv, zbatim më të fortë të ligjit dhe përafrim me standardet e BE-së në qeverisjen digjitale (e-qeverisje) dhe menaxhimin e kufijve.

Expected results:

- Një platformë e brendshme e krijuar dhe funksionale për menaxhimin e proceseve të kontrollit dhe hetimit brenda Administratës Doganore;
- Qasje e përmirësuar, menaxhim i të dhënave dhe informacionit, në lidhje me operacionet doganore, monitorimin dhe hetimet;
- Kapacitet i forcuar për të mbështetur hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të krimit ndërkufitar përmes mjeteve të përmirësuara të mbajtjes së të dhënave dhe analizës;
- Infrastrukturë e përmirësuar e TI-së me pajisje me performancë të lartë, duke siguruar përpunim të besueshëm, të sigurt dhe frytdhënës të të dhënave;
- Efikasitet, koordinim dhe efektivitet i rritur i aktiviteteve të kontrollit dhe hetimit doganor.